

V E N D I M
Nr.541, datë 14.11.1994

**PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË EMBARGOS NË MBËSHTETJE TË REZOLUTËS 820
TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË**

Për forcimin e mëtejshëm të embargos ndaj Serbisë dhe Malit të Zi, Këshillit i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Subjektet private që importojnë naftë ose nënprodukte të saj, janë të detyruara të paraqesin në organet doganore kontratat paraprake për livrimin e mallit për çdo sasi që do të importohet nga ana e tyre.

2. Subjektet private që tregtojnë naftë e nënprodukte të saj me shumicë, të prodhuara në vend ose të importuara nga ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të paraqesin pranë tyre kontratat paraprake të lidhura me subjektet që tregtojnë shitjen me pakicë të këtyre produkteve.

3. Subjektet transportuese janë të detyruara të përpilojnë dokumentacionin shoqërues të mallit që transportojnë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe kontratat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ndalohet tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në mënyrë ambulante, me përjashtim të atyre subjekteve që disponojnë mjete të specializuara dhe janë të pajisura me leje të posaçme nga organet e pushtetit lokal vetëm për vajgurin dhe për për nevojat e punimeve në bujqësi.

5. Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me Ministrinë e Transporteve dhe Komunikacioneve, ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët në lidhje me kushtet që duhet të plotësojnë mjetet e transportit të naftës dhe produkteve të saj dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Burimeve Minerare dhe Energjetike, ngarkohen të nxjerrin udhëzim të përbashkët në lidhje me kushtet që duhet të plotësojnë rezervuaret e depozitimit të naftës dhe nënprodukteve të saj sipas dispozitave të MNZ-së në fuqi.

6. Ndalohet depozitimi i çdo sasive karburanti pranë liqeneve, lumenjve dhe përgjatë gjithë brezit kufitar me Serbinë dhe Malin e Zi. Shtrirja e brezit kufitar caktohet nga Ministria e Rendit Publik.

7. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë që brenda datës 10 dhjetor 1994 të paraqesë në Këshillin e Ministrave projektvendimin dhe kriteret përkatëse për licencimin e tregtimit me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj.

8. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të përpunojnë planin e shpërndarjes së licencave për importin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj sipas një plani vjetor. Nga ky vendim bëjnë përjashtim vetëm vajrat lubrifikante, për tregtimin e të cilave do të veprohet sipas një udhëzimi të përgatitur nga Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 dhjetor 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi